




Funded by
the European Union

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE #2

Korniza Ligjore për Menaxhimin e Resurseve Ujore



Promoting Universal
Access to **Clean Water**

Let's do it  **Peja!**

SQARIM

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Let’s Do It Peja.

Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

KORNIZA LIGJORE PËR MENAXHIMIN E RESURSEVE UJORE

Mars, 2023

Përmbajtja

Shkurtesat.....	5
1. HYRJE.....	6
2. LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS.....	6
2.1 Qëllimi i Ligjit.....	6
2.2 Fushëveprimi i Ligjit.....	7
3. ZBATIMI I LIGJIT.....	8
3.1 Miratimi dhe publikimi i legjislacioni sekondar.....	8
3.1.1 Udhëzimet Administrative.....	8
3.1.2 Vendimet e dala nga ligji.....	10
3.1.3 Hartimi dhe miratimi i dokumenteve planifikuese.....	10
3.1.4 Zbatimi i ndryshimeve të parapara institucionale.....	11
4. MANGËSITË E LIGJIT PËR UJËRAT E KOSOVËS.....	13
4.1 Përkufizimet e gabueshme/të panevojshme.....	13
4.2 Përkufizimet që mungojnë.....	13
4.3 Rregullimi i mangët dhe Joadekuat i Pasurisë Ujore.....	14
4.4 Monitorimi i UJËRAVE.....	14
4.5 Çështjet tjera.....	14
5. KONKLuzionet.....	15
6. POLITIKA E REKOMANDUAR.....	16
Referencat.....	18

SHKURTESAT

ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
BE	Bashkimi Europian
DKU	Direktiva Kornizë e Ujërave
KE	Komisioni Europian
KNU	Këshilli Ndërministror për Ujëra
MIRU-K	Shkurtesa e projektit: Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore - Kosovë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
SIDA	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtarë e Suedisë
UA	Udhëzim Administrativ

1. HYRJE

Në Kosovën e pasluftës, korniza ligjore për menaxhimin e resurseve ujore është krijuar për herë të parë në vitin 2004 me nxjerrjen e Ligjit për Ujërat e Kosovës (Ligji nr. 2004/24) i cili është dekretuar¹ më 14 tetor 2004. Ky ligj kishte vendosur parimet për administrimin me ujërat e Kosovës dhe kishte rregulluar çështjet relevante për administrimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësinë e institucioneve në fushën e ujërave përfshirë edhe vendosjen e një kuadri institucional për administrimin e resurseve ujore në Kosovë. Në vitin 2013 (më 19 mars 2013), Kuvendi i Kosovës kishte miratuar një ligj të ri për ujëra – Ligjin për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 – i cili e kishte shfuqizuar Ligjin e vitit 2004.

Parimet bazë për administrimin e resurseve ujore si, parimi *shfrytëzuesi paguan, ndotësi paguan, menaxhimi i integruar i resurseve ujore, menaxhimi i ujërave sipas pellgjeve lumore* etj., janë të njëjta në dy këto ligje. Megjithatë, duke marrë parasysh se ligji i vjetër ishte nxjerrë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, për dallim prej ligjit të parë, me ligjin e ri është definuar edhe pronësia e resurseve ujore si “pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës”. Përpos kësaj, me ligjin e ri janë përfshirë edhe disa ndryshime sa i përket kuadrin institucional si: themelimi i një Autoriteti të Rajonit të Pellgjeve Lumore (ligji i vjetër i kishte paraparë dy autoritete), themelimi i Këshillit Ndërmnistror për Ujërat si organ ndërmnistror vendim-marrës i udhëhequr nga Kryeministri (ligji i vjetër e kishte Këshillin e Kosovës për Ujëra si organ i pavarur këshillë-dhënës për Kuvendin e Kosovës, i përbërë nga ekspertë të sektorit) dhe themelimi i Institutit për Ujëra.

2. LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS

2.1 QËLLIMI I LIGJIT

Qëllimi i këtij ligji, është së pari të definojë pronësinë e resurseve ujore, të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1: “Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj”.

Mirëpo ka shumë raste kur një komunë, fshat apo komunitet nuk lejon, pra kundërligjshëm, komunën, fshatin apo komunitetin fqinj të shfrytëzoj resursin ujor në territorin e tyre. P.sh. kuvendi komunal i Istogut ka marr vendim të mos ndajë burimin e vet me komunën e Klinës, apo fshati Budakovë me fshatin Vraniq në komunën e Suharekës, apo komuniteti boshnjak në fshatrat e Zhupës, e plotë raste të tilla që tolerohen në kundërshtim me ligjin.

¹ Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/41

Paragrafi 2 i të njëjtit nen qartëson më tej se qëllimi i ligjit është që të përcaktojë parimet dhe procedurat si dhe të themelojë institucionet adekuate me të cilat sigurohet shfrytëzim optimal i resurseve ujore në njërin anë, dhe mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja, tejshfrytëzimi dhe keqpërdorimi në anën tjetër, në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm i resurseve ujore në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillim ekonomik të Kosovës.

2.2 FUSHËVEPRIMI I LIGJIT

Fushëveprimi i Ligjit përfshin ‘rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat.’

Pra, Ligji rregullon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me administrimin dhe financimin e menaxhimit të resurseve ujore duke përfshirë: (i) shfrytëzimin e tyre, (ii) mbrojtjen e tyre, dhe (iii) mbrojtjen nga to. Përgjegjësitë për këtë ia delegon Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), dhe agjencisë në kuadër të saj, Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL).

Duhet theksuar se ligji nuk rregullon shërbimet e ujit, pra shërbimet me ujësjellës dhe kanalizime apo trajtimin e ujërave të zeza, ndonëse MMPHI financon dhe/ose menaxhon projekte të tilla. Sipas përgjegjësisë institucionale dhe kornizës ligjore si dhe sipas vendimeve të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra (KNU), kjo fushë-veprimtari i takon Kompanive Rajonale të Ujit, rrjedhimisht Ministrisë së Ekonomisë si aksionar i këtyre ndërmarrjeve publike.

Të vetmin përjashtim që ligji e bën sa i përket përgjegjësisë përtej resurseve ujore, është tek KNU, si një “trup koordinues dhe vendimmarrës, që shqyrton çështjet sistimore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujqor të Kosovës”.

3. ZBATIMI I LIGJIT

3.1 MIRATIMI DHE PUBLIKIMI I LEGJISLACIONI SEKONDAR

3.1.1 Udhëzimet Administrative

Me Ligjin për Ujëra janë përcaktuar gjithsej 19 udhëzime administrative (UA) si dhe një numër i konsiderueshëm i vendimeve për çështje të ndryshme. Afati i nxjerrjes së këtyre, sipas nenit 110, paragrafi 7 të Ligjit për Ujëra është përcaktuar të jetë 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit. Kjo do të thotë që të gjitha aktet nënligjore është dashtë të **miratohen deri në mesin e tetorit të vitit 2014**. Megjithatë, siç shihet nga tabelat e mëposhtme kjo nuk ka ndodh, duke ndikuar dukshëm në zbatimin e ligjit dhe gjendjen e resurseve ujore.

Tabela 1: Statusi i akteve nënligjore që kërkohen me Ligjin për Ujërat e Kosovës

Nr.	Udhëzimet Administrative dhe Rregulloret që kërkohen me Ligjin për Ujëra	Hartuar dhe miratuar	Data e miratimit ²	UA i ri
1	Neni 8 – <u>Statusi i Pasurisë Ujore Artificiale</u>	+	29.09.2016	
2	Neni 18 – <u>Rregullorja e punës e Këshillit Ndërmintrosor për Ujëra</u>	+	04.06.2014	
3	Neni 20 – Statuti i Institutit për Ujëra të Kosovës	-	Nuk është miratuar	
4	Neni 22 – <u>Detyrat dhe Përgjegjësit e ARPL</u>	+	23.12.2016	
5	Neni 42 – <u>Digat dhe rezervuarët</u>	+	04.07.2017	
6	Neni 47 – <u>Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave</u>	+	16.12.2015	
7	Neni 48 – <u>Mbrojtja e brigjeve të rrjedhave ujore</u>	+	07.09.2016	
8	Neni 54 – <u>Shpallja e zonave erozive</u>	+	23.12.2016	
9	Neni 58 – <u>Klasifikimi i trupave ujorë sipërfaqësorë</u>	+	08.12.2017	
10	Neni 59 – <u>Klasifikimi i trupave ujorë nëntokësorë</u>	+	08.12.2017	
11	Neni 60 – Vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në recipient dhe rrjet të kanalizimit	+	30.12.2014	17.05.2022
12	Neni 65 – <u>Prurja e pranueshme ekologjike</u>	+	11.08.2016	
13	Neni 66 – <u>Zonat e mbrojtura ujore</u>	+	08.12.2017	30.12.2022 (plotësim-ndryshim)
14	Neni 66 – <u>Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike</u>	+	20.11.2015	
15	Neni 68 – <u>Zona për larje</u>	+	17.12.2015	
16	Neni 71 – <u>Procedurat për dhënie të lejeve ujore</u> (përfshi neni 72 – Leje Ujore)	+	29.08.2018	
17	Neni 81 – <u>Sistemi i Informacionit për Ujëra</u>	+	17.06.2013	
18	Neni 92 – <u>Përcaktimi i Pagesave ujore</u>	+	18.02.2016	29.07.2021
19	Neni 95 – <u>Prezantimi i inspektorit</u>	+	X.12.2013	

² Të hijezuara (dhe me tekst të kuq) janë UA të miratuara pas afatit ligjor - mesi i tetorit 2014.

Nga tabela e mësipërme shihet se:

- Janë hartuar dhe miratuar të gjitha aktet nënligjore kryesore por vetëm dy nga to brenda afatit ligjor (*Rregullorja e Punës e Këshillit Ndërministror për Ujëra dhe UA për Sistemin Informativ Ujor*)³;
- Nuk është hartuar vetëm një akt nënligjor - statuti i Institutit për Ujëra. *Themelimi i Institutit për Ujëra nuk konsiderohet çështje me prioritet në mungesë të kuadrit profesional dhe rrjedhimisht nuk është iniciuar themelimi i tij dhe hartimi i statutit.*

3.1.2 Vendimet e dala nga ligji

Përpos UA dhe Rregulloreve, janë edhe disa vendime që duhen nxjerrë nga Ministri. Në tabelën e poshtme janë vendimet dhe statusi i tyre.

Tabela 2: Statusi i nxjerrjes së vendimeve që kërkohen me Ligjin për Ujërat e Kosovës

Nr	Vendimet që kërkohen me Ligjin për Ujëra	Hartuar dhe miratuar
1	Neni 38(1) – Përcaktimi i statusit të objekteve dhe pajisjeve ujore	JO
2	Neni 50(1) – Përcaktimi i vijës së plotave	JO
3	Neni 54(1) – Përcaktimi i zonave erozive	JO
4	Neni 56(3) – Përcaktimi i segmenteve të lumenjve ku mund të nxjerrën inertet	JO
5	Neni 58(2) – Klasifikimi i trupave ujorë sipërfaqësorë	JO
6	Neni 59(3) – Klasifikimi i trupave ujorë nëntokësorë	JO
7	Neni 68(2) – Përcaktimi i zonave për larje	JO
8	Neni 78(3) – Dhënia e koncesioneve për shfrytëzim komercial të ujit	JO
9	Neni 81 – Zhvillimi dhe azhurnimi i sistemit informativ ujor	JO
10	Neni 82 – Zhvillimi dhe azhurnimi i protokollit ujor (Librit Ujor)	JO
11	Neni 83 – Zhvillimi dhe azhurnimi i kadastrit ujor	JO

Pra, asnjë nga vendimet që kërkohen me Ligj nuk janë nxjerrë deri më sot.

3.1.3 Hartimi dhe miratimi i dokumenteve planifikuese

Me Ligj janë paraparë të hartohen dhe miratohen dokumentet planifikuese si vijon:

- Strategjia shtetërore për ujëra
- Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore
- Programi për monitorimin e ujërave, dhe
- Programi i masave.

Prej këtyre dokumenteve planifikuese deri tash është hartuar dhe miratuar vetëm *Strategjia shtetërore për ujëra 2017-2036*. Mirëpo, ligjërisht kjo strategji ka qenë dashur të rishikohet çdo pesë vite, dhe ndonëse një draft ishte përgatitur, strategjia e rishikuar për periudhën 5-vjeçare, 2022-2026 akoma nuk është miratuar.

³ 6 kanë qenë të miratuara më herët nga ligji i ujërave 2004/24 dhe nuk kanë qenë të harmonizuara me ligjin e ri brenda afatit ligjor

Marrë parasysh që *Programi i Masave* duhet të jetë pjesë përbërëse e *Planit për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore*, rrjedhimisht nuk ka nevojë të nxjerret si dokument i veçantë. Ndërsa sa i përket planeve, *Plani për Menaxhimin e Pellgut Drini i Bardhë* është hartuar me asistencë të SIDA⁴ dhe është dorëzuar në nëntor 2022 por akoma nuk është proceduar për diskutim publik dhe miratim nga Qeveria. Planet për 3 pellgjet tjera janë duke u përgatitur me asistencë nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim përmes programit të bashkëfinancuar me qeverinë, Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë (MIRU-K), ku draftet e para priten të dorëzohen në maj 2023.

Kurse, Plani për Monitorimin e Ujërave është punuar nga një grup punues i brendshëm i Ministrisë qysh në 2013, por që ky dokument pritet të revidohet përmes programit MIRU-K.

3.1.4 Zbatimi i ndryshimeve të parapara institucionale

Me Ligj janë themeluar tri institucione të reja, si vijon:

- 1) Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNU) që udhëhiqet nga Kryeministri dhe që ka në përbërjen e vet edhe 4 ministra të linjës,
- 2) Instituti i Kosovës për Ujëra në kuadër të MMPHI,
- 3) Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) në kuadër të MMPHI që i përgjigjet Ministrisë.

Prej këtyre 3 institucioneve të themeluara me Ligj, 2 tashmë janë themeluar: KNU dhe ARPL⁵, por kjo e fundit akoma ka statusin e një departamenti të MMPHI, gjë nuk është në pajtim me Ligjin.

Gjithashtu, sipas *Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës: 2017-2036*, vendosja e ARPL si departament brenda Ministrisë ka qenë vetëm një zgjidhje fillestare dhe e përkohshme me qëllim për t'u ngritur më pas në nivel agjencie, sipas ligjit të ujërave. Së fundmi, vendimi i KNU nr. KNMU/K/03/2018 i datës 07.12.2018 është që të fillohet me këtë proces. Rishtazi, edhe komuniteti i donatorëve ka kërkuar që të përfundohet ky proces (raportet e KE për Kosovën kërkojnë në vazhdimësi funksionalizimin e ARPL) dhe një obligim i tillë është futur në marrëveshjen mes Qeverisë dhe Qeverisë Zvicerane për programin MIRU-K.

Kurse, institucioni i tretë që pritej të themelohej me ligjin e ujërave, Instituti i Kosovës për Ujëra, nuk është themeluar, por dhe nuk shihet me rëndësi të themelohet, për shkak të mungesës së kuadrit profesional.

⁴ Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar ('Swedish International Development Agency')

⁵ Ish Departamenti i Ujërave ishte shkruar në Departamentin e ARPL (qershor 2017) me qëllim për t'u ngritur më pas në nivel agjencie, sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës.



Figura 1. Bashkimi i lumenjëve Llapi dhe Sitnica në fshatin Lumadh

4. MANGËSITË E LIGJIT PËR UJËRAT E KOSOVËS

Gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore që kërkohen sipas këtij ligji, janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i mangësive teknike dhe përmbajtësore që shkaktojnë paqartësi dhe rrjedhimisht ndikojnë në zbatimin e tij. Për më tepër, ky ligj në formën si është, ka dështuar t'i transpozojë shumë prej koncepteve dhe parimeve të Direktivës Kornizë për Ujëra që është legjislacioni bazë i BE-së në fushën e menaxhimit të resurseve ujore.

4.1 PËRKUFIZIMET E GABUESHME/TË PANEVOJSHME

Duhet theksuar këtu se përkufizimet fillimisht ishin marr nga Direktiva Kornizë e Ujërave e BE-së dhe ishin përkthyer në gjuhën shqipe me mangësi duke i bërë ato të pakuptueshme ose të gabuara. P.sh.:

- Në ligj janë përkufizuar disa terma dhe nocione inekzistente si: 'pellgu uJOR', 'retenzioni', 'nxjerrje', 'pasuria ujore artificiale'
- Ka përsëritje të panevojshëm të disa definicioneve si: 'regjimi uJOR' dhe 'regjimi i ujërave', 'përdorimi i ujit' dhe 'shfrytëzimi i ujit'.
- Disa përkufizime janë formuluar (përkthyer) në formë joadekuate që për pasojë këto përkufizime nuk janë në pajtueshmëri me përkufizimet në Direktivën Kornizë të Ujërave të BE:
 - 'ujërat sipërfaqësor' – duhet: 'të gjitha ujërat e brendshme përpos ujërave nëntokësore'.
 - 'trup uJOR sipërfaqësor' – duhet: 'një element i veçantë dhe sinjifikativ (i konsiderueshëm) i ujërave sipërfaqësore si liqen,...'
 - 'ujërat e brendshme' – duhet: 'të gjitha ujërat e ndenjura ose rrjedhëse në sipërfaqen e tokës si dhe ujërat nëntokësore'
 - 'nën-pellg' – duhet: 'sipërfaqja e tokës nga e cila rrjedhin të gjitha ujërat sipërfaqësore përmes një sërë rrjedhave, lumenjve dhe, ka mundësi edhe, liqeneve tek një pikë e veçantë e një ujërrjedhe (normalisht një liqe ose lumë tjetër)'
 - 'parimi universal i shërbimeve ujore' – duhet: 'parimi i shërbimit universal'.
- Disa përkufizime me rëndësi për qëllim të ligjit mungojnë, si: 'përmbytje/vërshim', 'zonat e ndjeshme' (sensitive), 'ujërat ndërkufitare'
- Përpos kësaj, në ligj është përdorur pa kurrfarë dallimi nocioni 'pasuri ujore' dhe 'resurs uJOR'. Për më tepër, nuk është përkufizuar fare çka është 'pasuri ujore'.

4.2 PËRKUFIZIMET QË MUNGOJNË

Në ligj nuk janë përfshirë përdorimi i një numri të madh të nocioneve bazë të përkufizuara me Direktivën Kornizë të Ujërave të BE-së: 'shërbimet e ujit', 'uji për konsum njerëzor', 'vlerat kufitare të emisioneve', 'trup uJOR nëntokësorë', 'akuifer', 'statusi i ujërave nëntokësore', 'statusi i ujërave sipërfaqësore', 'statusi i mirë i ujërave nëntokësore', 'statusi i mirë i ujërave sipërfaqësore', 'statusi ekologjik', 'statusi i mirë ekologjik', 'statusi sasior', 'trup i modifikuar rëndë', 'rezervat e disponueshme të ujërave nëntokësore', 'kontrolli i emisioneve'.

4.3 RREGULLIMI I MANGËT DHE JOADEKUAT I PASURISË UJORE

Pasuria ujore është një koncept i cili normalisht përfshin tokën ujore dhe brezin bregudor. Në legjislacionin ujor të disa shteteve (p.sh. Sllovenia dhe Mali i Zi) pasuria ujore përfshin ujërat dhe tokën ujore. Në Ligjin për Ujëra të Kosovës kjo çështje nuk është rregulluar në mënyrë të qartë. Kështu, tek përkufizimet thuhet që resurset ujore përfshijnë trupat ujorë dhe tokën ujore, gjë që do të mund të kuptohej se këtu resurset ujore kanë kuptimin e pasurisë ujore. Në anën tjetër, në nenin 8 përdoret termi *pasuri ujore artificiale*. Kjo pasuri ujore artificiale pastaj nuk është rregulluar në mënyrë të plotë dhe të qartë. Për më tepër, në nenin 10 të Ligjit thuhet se “pronari ose poseduesi i ujërave dhe resurseve ujore, nuk ka të drejtë në kompensim...” që lë të kuptohet që ky pronar mund të jetë ndonjë entitet publik ose privat, e që është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit i cili thotë shprehimisht se resurset ujore janë pronë e Republikës së Kosovës.

4.4 MONITORIMI I UJËRAVE

Me Ligj (nenin 35) është përcaktuar se programi i monitorimit të ujërave hartohet për periudhë 40 vjeçare. Kjo është një periudhë tepër e gjatë e cila nuk haset në asnjë prej legjislacioneve të vendeve të rajonit. Përkundrazi, është praktikë standarde që programet e monitorimit të ujërave hartohen në baza vjetore (ose eventualisht 3-vjeçare). Për më tepër, sa i përket monitorimit të ujërave nuk janë transpozuar në Ligj llojet e monitorimit të cilat janë të përcaktuara me DKU të BE-së: monitorimi mbikëqyrës, monitorimi operativ dhe monitorimi hetues që janë të domosdoshme për përcaktimin e statusit të ujërave dhe klasifikimin e tyre.

4.5 ÇËSHTJET TJERA

Përpos mangësive të mësipërme, me Ligjin për Ujërat e Kosovës nuk janë transpozuar në mënyrë të duhur aspekte të rëndësishme të legjislacionit të BE-së si mbrojtja nga përmytjet, ndotja difuzive dhe pikore e ujërave, shkarkimi i ujërave të ndotura industriale, modalitetet e dhënies së koncesionit për shfrytëzim të ujërave, etj. Duke e pasur parasysh që Kosova aspiro integrimin në BE dhe në këtë kontekst ka adoptuar politikën e harmonizimit të legjislacionit të vet me *acquis communautaire*, do të duhej që të transpozohen në tërësi dispozitat e direktivave të BE-së nga fusha e ujërave (Direktiva Kornizë e Ujëave, Direktiva e Ujërave Nëntokësore, Direktiva e Ujërave për Larje, Direktiva e Përmytjeve, Direktiva e Nitrateve, Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane, Direktiva e Substancave Prioritare etj.).



Figura 2. Lumi Drini i Bardhë

5. KONKLUZIONET

- Statusi aktual i ARPL si departament i MMPHI nuk është në pajtim me Ligjin 04/L-147 për Ujërat e Kosovës. Duke marrë parasysh kompetencat dhe karakteristikat e ARPL të përcaktuara në Ligji, ARPL duhet të cilësohet si organ qendror i administratës shtetërore, sepse ushtron kompetenca të cilat shtrihen në tërë territorin e Kosovës, është vartës i Ministrisë, dhe është i themeluar me ligj (Ligji nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenet 23 dhe 28, para. 2). Si organ qendror i administratës shtetërore, i cili është vartës i Ministrisë, ARPL do të duhej të ishte organizuar sipas mënyrës së përcaktuar në Ligjin nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.
- Ka pasur dhe ka ngecje të theksuar të zbatimit të ligjit qoftë në hartimin e akteve nënligjore, harmonizimin dhe/ose zbatimin e tyre, në (mos)nxjerrjen e vendimeve që do të duhej të dalin nga ligji dhe dokumenteve planifikuese.
- Në vend që të fokusohet në zbatimin e ligjit dhe mbrojtjes së resurseve ujore për çfarë është ligjërisht përgjegjëse, MMPHI ka financuar dhe menaxhuar projekte të shërbimeve ujore (ujësjellës dhe kanalizime, përfshirë impiante për trajtimin e ujërave të zeza), në

kundërshtim me përgjegjësitë ligjore të saj të definuara qartë me nenet 1, 2 dhe 13 të ligjit të ujërave, në kundërshtim me nenin 35.A të [ligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit](#) që specifikon qartazi se “Investimet në sektorin e shërbimeve të ujit do të bëhen drejtpërdrejt përmes ofruesve të shërbimeve të ujit apo Ministrisë përgjegjëse për ndërmarrjet publike”. Për më tepër, kjo ndarje e përgjegjësiave institucionale është e shprehur qartazi edhe në politikën e Qeverisë për Ujëra e miratuar me 3 qershor 2015 si dhe është në kundërshtim me vendimet e takimeve 7 dhe 8 të Këshillit Ndërmarrës për Ujërat.

- Përkundër faktit se me Ligj është përcaktuar që shfrytëzimi i ujërave për qëllime komerciale duhet të bëhet përmes koncesionit (neni 78), deri tashti MMPHI nuk ka respektuar këtë dispozitë të ligjit. Dhënia në shfrytëzim e ujërave (për prodhimin e energjisë, për ujë të ambalazhuar, për kultivim të peshqve) është bërë dhe bëhet përmes lejeve ujore pa proces konkurrues.
- Nuk është e definuar dhe trajtuar prona ujore, mënyra e evidentimit, kur fitohet e kur humbet statusi i pronës ujore, kush është titullari, harmonizimi me ligjin mbi kadastrin, etj.

6. POLITIKA E REKOMANDUAR

- Të hartohet ligj i ri dhe të titullohet *Ligji për menaxhimin e resurseve ujore*, me qëllim emërtimi i tanishëm si ligj i ujërave shkakton keqkuptime gjatë implementimit dhe shpesh MMPHI ndërhyr në sektorin e shërbimeve ujore (shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimit).
- Me Ligjin e ri për ujëra të traspozohen në tërësi dispozitat e direktivave relevante të BE-së nga fusha e ujërave.
- Ligji i ri të përcaktojë që alokimi i resurseve ujore për shërbim të furnizimit me ujë është me interes të përgjithshëm.
- Pavarësisht ligjit të ri, ARPL qysh tani duhet të ngritet në nivel agjencie sipas ligjit në fuqi, sipas raporteve të BE dhe sipas marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicerane për programin MIRU-K, dhe sa më shpejtë në mënyrë që të sigurohen projektet afatgjate për fuqizimin e ARPL dhe menaxhimin e resurseve ujore. Duhet të theksohet qartazi se ARPL është organ i administratës shtetërore.
- Pavarësisht, ligjit të ri, qysh tani, të nxjerret akti nënligjor me të cilin definohen kushtet, afatet, dhe aspektet tjera për ndarjen e koncesioneve. UA për leje ujore nuk e trajton këtë të drejtë ujore dhe tejkalon fushëveprimin e vet duke u marr me administrimin e ujërave në pronat e ndërmarrjeve publike. Duhet të qartësohet se objektet dhe pajisjet ujore nuk përfshijnë asetet e ndërmarrjeve publike për shërbime të ujit, megjithëse se ligji është i qartë se ka për qëllim vetëm resurset ujore

- MMPHI të kontrollojë dhe regjistrojë gjithë operatorët dhe të caktojë afate për aplikim operatorëve që i përmbushin kushtet, sipas së drejtës ujore përkatëse të definuar në ligj, pra për shfrytëzim komercial e drejta ujore të jepet me koncesion.
- MMPHI duhet urgjentisht të definojë çështjen e pronave ujore.
- Ligji i ri, në harmonizim me Direktivën Kornizë për Ujëra, të theksojë nevojën e ruajtjes së *statusit të mirë të ujërave*.
- Ligji i ri, në harmonizim me Direktivën për Ujë të Pijshëm, të theksojë nevojën e identifikimit të burimeve ujore për furnizimin me ujë të pijshëm.
- Ligji i ri të mos përcaktojë krijimin e Institutit për Ujëra, në mungesë të kuadrit profesional, realitet që vërehet në gjitha institucionet përkatëse për menaxhimin e resurseve ujore. Instituti për hulumtime në fushën e ujërave do të mund të krijohej në kuadër të fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit.
- MMPHI duhet të veprojë më aktivisht në parandalimin e ndotjes së resurseve ujore, shkarkimin e patrajtuar të efluentëve në resurset ujore, hedhjen e mbeturinave në lumenjtë e Kosovës.
- Menaxhimi i erozionit është inekzistent! MMPHI duhet të rekrutojë dhe të aftësojë urgjentisht staf për menaxhimin e erozionit.
- Resurset ujore në Kosovë janë të pakta dhe të neglizhuara ndër vite nga ndotja, menaxhimi i tyre. Qeveria duhet të lejojë urgjentisht plotësimin e stafit të ARPL, Institutit Hidro-meteorologjik dhe Inspektorëve të ujërave, sidomos tani që ka projekte afatgjate për përkrahjen e këtyre institucioneve dhe po vërehet mungesa e kapaciteteve absorbuese.

Referencat

- [1] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013) *Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës*. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / No. 10*. Prishtina - <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>.
- [2] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018) *Strategjia Shtetërore për Ujëra 2017-2036*. Prishtinë.
- [3] Mihaela Popovici (2020) *Support to the European Integration Process in Kosovo: Legal Approximation on Chapter 27 Environment, Sub-Chapter Water Acquis*. GIZ. Prishtina.
- [4] Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (2021) *Raport i Grupit Punues për Shqyrtimin e Procedurave Administrative të Zbatuara për Hidrocentrale dhe Ndikimin e Tyre në Mjedis*. Prishtinë.
- [5] Qeveria e Republikës së Kosovës – Këshilli Ndërmintor për Ujëra (2019). *Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Ligjit për Ujërat e Kosovës*. Prishtinë.
- [6] Qeveria e Republikës së Kosovës (2014) *Udhëzues Praktik për Përafrimin Ligjor të Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e Bashkimit Europian*. Prishtinë.
- [7] Qeveria e Republikës së Kosovës (2021) *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025*. Prishtinë.



**Funded by
the European Union**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Let’s Do It Peja.

Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Let’s Do It Peja
Address: Shtëpia e Kulturës, kati III
30000, Pejë, Kosovë
Email: letsdoitpeja@gmail.com
Tel: +383 49 124 548



Promoting Universal
Access to **Clean Water**